We use cookies to improve your experience. By your continued use of this site you accept such use. To change your settings please see our policy. CLOSE

hako.al

Shpërthen mjeti luksoz i "të fortit" në Vlorë, i vunë tritol natën

Posted on 29 Janar, 2017 09:20 by L.B in Aktualitet, Kronika with 1 Comment

aa

Një automjet është djegur gjatë orëve të para të mëngjesit të sotëm në qytetin e Vlorës. Sipas Policisë, mësohet se mjeti është i tipit Audi Q7. Ai i përket personit të identifikuar si Flamur Peçaj, 46 vjeç, një emër i njohur për autoritetet. Lënda plasëse ishte vënë poshtë makinës së vlonjatit, e cila ka shpërthyer dhe ka marrë flakë. Sipas Policisë, ka vetëm dëme materiale. Policia po heton për personat që mund t'ia kenë vënë lëndën plasëse 46vjeçarit.

Ky i fundit njihet si person me precedentë penalë. Në vitin 2012, ai është arrestuar nga Policia pasi ka kërcënuar dy vëllezër me armë zjarri, shkruan "Panorama". Këta të fundit janë hakmarrë, duke e rrahur me sende të forta dhe me qytë armësh. Peçaj përfundoi asokohe në spital për shkak të plagëve.

Njoftimi i policisë

Në orët e para të mëngjesit është djegur pjesërisht një automjet i parkuar. Ngjarja ka ndodhur pranë pallatit të pronarit të mjetit në lagjen "Pavarësia", ku automjeti tip AudiQ7, në pronësi të shtetasit F.L (P), 46 vjeç, ka marrë flakë e për pasojë është dëmtuar pjesa e përparme e tij.

Nuk ka persona të lënduar. Dyshohet që mjeti mund të jetë djegur qëllimisht me një sasi të vogël të dyshuar lëndë plasëse, e cila është hedhur poshtë mjetit. Po punohet për hetime të mëtejshme në lidhje me sqarimin e rrethanave të ngjarjes dhe për identifikimin e autorit.

Shkrime të ngjashme

Përmbytjet/ Shkon në tre numri i viktimave



FOTO/ Një avion i vogël tenton që të ulet në Gjirin e Lalzit

Pranga taksistit në Gjirokastër, trafikonte emigrantë nga Siria

Tagged Kronike Shperthim Vlore

1 komente në "Shpërthen mjeti luksoz i "të fortit" në Vlorë, i vunë tritol natën"

Kellira

29 Janar, 2017 10:51 te 10:51 am

Ne Itali mafiozet levizin me Fiat Punto. Ketu ne Shqiperi nuk e rruajne fare. Me Q7 tipi i papune.
Detaj i mjaftueshem per te kuptuar se ku jetojme dhe pse duhet ikur nga ky vend naten madje me not.

PËRGJIGJJUNI

Lini një Përgjigje

Adresa juaj email nuk do të bëhet publike. Fushat e domosdoshme shënohen *

Koment

Emër *

Email *

Site Web

POSTOJE KOMENTIN

© 2016 Gazeta Tema. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Copy Protected by Chetan's WP-Copyprotect.